

EKONOMIA INFORMALE SI BARRIERË PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

nga:

**Prof. Asoc. Dr. Fatmir MEMA, Pedagog në Fakultetin e Ekonomisë, UT
Dr. Zef PREÇI, Këshilltar i Presidentit të Republikës**

Problemi i ekonomisë informale është një problem kryesor megjithëse në praktikë ai është një reagim i natyrshëm dhe spontan ndaj pamundësisë së ekonomisë formale për të plotësuar nevojat e një pjese të anëtarëve të shoqërisë. Duhet pranuar se në vendet në zhvillim e ato në tranzicion ekonomia informale jep një kontribut të konsiderueshëm për rritjen ekonomike, ndonëse duke u shoqëruar me një numër problemesh, të cilat meritojnë të trajtohen me kujdes nga hartuesit dhe nga zbatuesit e politikave ekonomike.

Është e vërtetë se të japësh një përkufizim të ekonomisë informale është diçka e vështirë. Kjo jo për shkak të vështirësive të njohurive rreth mënyrave të matjes dhe të vlerësimit të përmasave dhe të shtrirjes së këtij sektori, por edhe sepse autorë të ndryshëm e shikojnë problemin nga këndvështrime të ndryshme dhe japin përkufizime të përafërta, por gjithsesi të ndryshme.

Kështu në ekonominë informale (e quajtur edhe ekonomia hije, ekonomia paralele, ekonomia e nëndheshme, ekonomia jozyrtare) përfshihen njësi të vogla të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve dhe që nuk janë të regjistruara si njësi formale, janë njësi që funksionojnë në prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve, që janë të regjistruara si njësi formale, por që deklarojnë vetëm pjesërisht vëllimin e aktivitetit të tyre, janë njësitë prodhuese ose të shërbimeve që krijohen në bazë familjare dhe gjithnjë të paregjistruara, janë shpesh persona fizikë që, ushtrojnë aktivitetin e tyre pa licencë dhe disa autorë si shtojcë të veçantë përfshijnë edhe veprimtaritë ekonomike të ndaluara me ligj dhe ato kriminale.

Mbase më e saktë do të ishte të thuhej se ekonomia informale është ajo pjesë e ekonomisë “së ligjshme” (jo e ndaluar dhe kriminale), e cila nuk respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe që do të ishte objekt taksimi në rast se do të raportohet tek organet fiskale. Në varësi të vendeve të ndryshme zakonisht ekonomia informale zë nga 10 – 50 për qind të PBB-së, duke qenë më e ulët në vendet e zhvilluara dhe më e lartë në vendet në zhvillim dhe në tranzicion.

Një ekonomi informale në lulëzim i bën statistikat zyrtare mbi papunësinë, mbi forcat e punës, mbi të ardhurat, mbi konsumin etj. të pabesueshme dhe për pasojë, programet dhe politikat e hartuara mbi bazën e këtyre statistikave mund të jenë të papërshtatshme për zbatim. Pa dashur të nxjerrim konkluzione të shpejtuara, mund të hidhet edhe hipoteza se ***arritjet modeste në zbatimin e strategjisë së reduktimit të varfërisë dhe të zhvillimit ekonomik, të shprehura në pamundësinë për të konvertuar arritjet e njohura makroekonomike në zhvillim rajonal dhe sektoral, kanë si shkak veç të tjerave, edhe peshën ende të konsiderueshme të sektorit informal të ekonomisë dhe mungesën e instrumenteve, që mundësojnë***

formalizimin e saj pa e dëmtuar, domethënë duke “e zbardhur” atë në favor të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit tonë.

Elemente të shkëputura të veprimtarive informale (disa shërbime publike në shtëpi: riparim televizorësh e lavatriçesh; shërbime humane: vizita mjekësore, bërje inxheksionesh etj; kurse të gjuhëve të huaja, tregti në rrugët e qyteteve dhe të qendrave të banuara e produkteve bujqësore nga fshatarë të zonave përreth tyre; marrje “në natyrë” për nevoja familjare e një sasive produktesh bujqësore e blegtorale nga punëtorët me mëditje të kohës: anëtarët e kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore; marrja për nevoja familjare e lëndëve të para të ndryshme nga repartet e ndërmarrjeve industriale etj.) kanë qenë të pranishme edhe në periudhën e ekonomisë së centralizuar.

Ndërsa prania në shkallë të gjerë dhe të menjëhershme e veprimtarive ekonomike informale në Shqipëri erdhi kryesisht si pasojë e shembjes së institucioneve të ekonomisë së centralizuar, e boshllëkut ligjor dhe institucional të krijuar menjëherë pas kësaj dhe e dobësive fillestare të shtetit për të krijuar institucione ligjore e fiskale të përshtatshme për një ekonomi tregu. Nuk duhen neglizhuar edhe efektet shkatërruese të krizave me të cilat është përballur vendi gjatë kësaj periudhe si dhe polarizimi ekonomik dhe social tepër i madh dhe konstant, gjatë gjithë periudhës së tranzicionit deri në ditët e sotme. Këtu duhet të theksojmë se është pikërisht ky polarizim, i cili në disa raste i realizuar në mënyra të dyshimta, ka sjellë në skenë edhe debatin e gjerë për amnistinë fiskale.

Mendojmë se faktorët kryesorë që çuan në fuqizimin e ekonomisë informale në këtë periudhë janë:

- Mbyllja masive e vendeve të punës në periudhën e parë të tranzicionit.
- Zhvendosjet e mëdha demografike drejt zonave fushore, drejt qyteteve të mëdha dhe sidomos drejt Tiranës.
- Politizimi i lartë i administratës shtetërore dhe ndërhyrjet e theksuara të politikës në vendimmarrjen ekonomike.
- Hartimi i një legjislacioni të ri dhe në përmirësim të vazhdueshëm, por që ende lë hapësira për një nivel të lartë të ekonomisë informale.

Efektet kryesore të ekonomisë informale janë mbi:

1. Treguesit monetarë. Veprimtaritë me natyrë informale priren të kryhen me të holla në dorë (në *cash*) duke rritur kështu kërkesën për monedhë në qarkullim.
2. Pjesëmarrjen në tregun e punës dhe kohëzgjatjen e saj. Nëse rritet numri i të punësuarve në ekonominë informale dhe orët e punës në të, atëhere do të bjerë shkalla e pjesëmarrjes në ekonominë zyrtare dhe numri përkatës i orëve të punës.
3. Statistikat zyrtare të prodhimit. Rritja e ekonomisë informale sjell për pasojë statistika më pak të besueshme dhe shifra më të ulëta për normën zyrtare të rritjes ekonomike.
4. Rritjen ekonomike. Ekzistojnë dy rryma të kundërta për efektin e ekonomisë informale mbi rritjen ekonomike. E para që rënia e ekonomisë informale ndikon në rritjen ekonomike, sepse rriten të ardhurat nga taksat që sjellin rritje të shpenzimeve publike; ndësa e

dyta, se ekonomia informale është më konkurruese dhe efikase në krahasim me sektorin formal, dhe se në këtë mënyrë nxitet rritja ekonomike.

5. Shpenzimet publike, në kushtet e nivelit të lartë të ekonomisë informale, çojnë në rritje të vetë ekonomisë informale dhe kjo, në një rreth vicioz, në rritje të taksave për të plotësuar nevojat e shpenzimeve publike.
6. Mundësitë potenciale për kalimin e një pjese të ekonomisë informale në ekonomi kriminale dhe në mbështetje financiare të krimit, dhe sidomos krimit ekonomik të organizuar.
7. Rritjen e korrupsionit përmes dhënies së ryshfeteve tek nëpunësit shtetërorë që kanë lidhje me kontrollin dhe me vjeljen e taksave, duke sjellë si pasojë korrupsionin dhe deformimin e veprimtarisë në punë të administratës shtetërore. Presione mjaft të forta ka në organet zyrtare në Shqipëri për punësim në administratën tatimore dhe sidomos në atë doganore.

Matja e ekonomisë informale mund të bëhet me:

A. Metoda të drejtpërdrejta me anë të:

1. Anketimeve; dhe
2. Kontrollit të taksave përmes statistikave të shpenzimeve dhe të ardhurave të firmave e atyre individuale.

B. Metoda të tërthorta përmes:

1. Statistikave të llogarive kombëtare (mospërputhja mes statistikave të të ardhurave dhe shpenzimeve në llogari kombëtare dhe individuale).
2. Statistikave të zënies me punë (ulja e pjesëmarrjes në punë në ekonominë formale duke supozuar se pjesëmarrja në punë ka një normë pjesëmarrjeje relativisht konstante).
3. Transaksioneve (të dhënat e vëllimit të transaksioneve monetare të ekonomisë për të llogaritur PBB-në totale dhe zyrtare).
4. Kërkesës për para (rritja e kërkesës për *cash* sepse transaksionet e ekonomisë informale kryhen në *cash*).
5. Konsumit të energjisë elektrike sepse është treguesi më i mirë fizik i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (diferencë midis rritjes së PBB-së dhe rritjes së konsumit të energjisë).

Për ta patur nën kontroll e për të mundësuar formalizimin gradual të ekonomisë informale, mendojmë se duhet të studjohet:

1. Roli i saj në ekonominë e vendit, pesha që zë në punësim dhe dinamika në sektorë të ndryshëm, në zbutje të pasojave sociale të tranzicionit etj..
2. Mjedisit ligjor që lë hapësira për ekonominë informale.
3. Problemet e sistemit të taksave, burokracia shtetërore dhe probleme të sigurimit social.
4. Puna e të miturve në sektorin informal.

Gjithashtu, theksojmë se me gjithë studimet e pjesshme të kryera nga studiues kryesisht të huaj, nga institucionet shtetërore dhe nga publikimet e medias, një vend më të madh në studimin e ekonomisë informale u duhet dhënë studiuesve vendas. Kjo, jo thjesht për faktin se tashmë janë akumuluar kapacitete të mjaftueshme intelektuale të shkolluara brenda dhe jashtë vendit, por edhe për shkak të një numri specifikash që paraqet ekonomia shqiptare në këtë periudhë të tranzicionit, gjë që vështirëson njohjen e saj e, për pasojë, edhe zbatimin e modeleve të njohura për vlerësimin e nivelit dhe të shtrirjes së ekonomisë informale.

Ndërmarrja e studimeve të përbashkëta që përfshijnë studiuesit vendas, institucionet shtetërore që merren me çështjet fiskale e të punësimit, si dhe institucionet e njohura ndërkombëtare për ekspertizë në këtë fushë do të ishte edhe rruga më efektive për studime të plota dhe që ofrojnë rekomandime politike të zbatueshme për këtë sektor.

Për të përfunduar, si rekomandime për uljen e nivelit të ekonomisë informale mendojmë:

1. Vendet me taksa të ulëta priren të kenë një nivel të ulët të ekonomisë informale. Por, theksojmë se ulja e taksave vetëm se e stabilizon por shpesh nuk e ul ekonominë informale, prandaj mendojmë se ka vend për rregullime të sistemit të taksave duke i bërë më të thjeshta në përmbajtje, më logjike për qytetarët dhe më të zbatueshme në kushtet e ekonomisë shqiptare. Vendorsja e urave midis kontributeve dhe përfitimeve nga sistemi fiskal, shihet si rruga kryesore që nxit qytetarët e bizneset për t'u orientuar drejt sektorit formal të ekonomisë.
2. Rregullat e ndërlikuar shtetërore për licencimin, për tregun e punës dhe për barrierat burokratike rritin ekonominë informale. Prandaj, mendojmë se ka mjaft raste kur duhen lehtësuar procedurat burokratike dhe të tepërta në dokumentacionin e licencimeve etj.. Janë bërë të ditura një numër studimesh në këtë fushë, por mbetet të shihet zbatimi i tyre në paketat fiskale përkatëse.
3. Ekonomia informale është më e ulët në vendet ku institucionet shtetërore janë më të fuqishme dhe më eficiente. Mendojmë se forcimi i parreshtur i këtyre institucioneve, rritja e besimit publik ndaj tyre mbeten rrugët më të sigurt për një zgjerim të formalizimit të ekonomisë dhe zvogëlim konstant të sektorit informal të saj.
4. Vendet me më shumë korrupsion kanë ekonomi informale më të lartë. Lufta ndaj korrupsionit, e kuptuar si forcim dhe konsolidim i institucioneve të shtetit, si rritje e ndërgjegjes qytetare dhe e përgjegjshmërisë individuale, si dhe forcimi e modernizimi i administratës publike mbeten premisa që ky sektor të vijë duke u zvogëluar gradualisht.

Literatura:

1. Holden P dhe Rajapatirana S “*The informal sector impacts*„ Newsletter i QshKE Nr. 9/1998.
2. Mema F., “*Disa hipoteza për korrupsionin në privatizim*”, Numër special i Revistës “Ekonomia dhe tranzicioni”, 1998.

3. Olters, J. P., "*The informal sector – impeding economic development?*„ Fourth conference of Bank of Albania "Albanian Economy: Performance and Policy Challenges,, Sarandë, Shtator 2003.
4. QShKE "*The informal sector in Albania: Unregistered employment and fiscal implication*„ Studimi, 1994.
5. Schneider F dhe Enste D., "*Rritja e ekonomise informale*„ Revista "Ekonomia dhe Tranzicioni,, Nr. 3 (33), 2002.